

Dita Botërore e Ambientit

RADIO SKRIPTA

FOLESI

Dita botërore e ambientit shenohet cdo vit me 5 qershor. Ne këtë ditë, Kombet e Bashkuara bëjnë thirrje për masat globale në mbrojtje të ambientit. Eshte koha që njerëzit të bëjnë dicka pozitive për shëndetin e planetit tone.

Ketu ne Kosove, Kombet e Bashkuara kane filluar projektin Hapat e Gjelber . Qellimi eshte, jo vetem qe te pastrohet Kosova, por , qe te mbahet e pastert permes masave parandaluese. Sipas Nora Sahatciu, qe punon per Kombet e Bashkuara ne Prishtine, ne kemi nevojë, jo vetem qe te mbrojme mjedisin për të mirën tonë - por edhe për brezat e ardhshme.

NORA SAHATCIU (U.N. KOSOVO TEAM)

Mendohet se ka nevojë për investime të mëdha financiare, por, përveq investimeve financiare është me rëndësi të theksohet se kas shumë investime dhe ka shumë mendësi që komuniteti, shoqëria civile dhe të gjithë qytetarët të organizohen dhe të veprojnë së bashku me minimumin e resurseve financiare.

FOLESI

Si pjesë e projektit Hapat e Gjelber , ngjites me ngjyre të gjelber në forme të gjurmëve të shputave të kembeve, janë vendosur neper trotuare, në mënyrë figurative që ti drejtojnë kembësoret në drejtim të shportave me mbeturina. Ideja është që të përdoret pak psikologji, të inkurajoj njerëzit që të përdorin shportat. Kur është bërë një projekt i ngjajshëm në Danimarkë, përdorimi i shportave është rritur për 46 përqind. Luan Hasanaj shpreston të shohë një trend të ngjashëm edhe në Kosovë. Grupi i tij i shoqërisë civile, që quhet Let s Do it Kosova e mbeshtet projektin Hapat e Gjelber.

Luan Hasanaj Alb.

LUAN HASANAJ (SHOQERIA CIVILE)

Eshtë një ide që ndoshta në të ardhmen të fillojmë edhe neper qytetet e tjera të Kosovës.. jemi deshmitare që edhe aty ku janë nuk përdoren aq shumë këstu që të provojmë përmes këtij projekti të sensibilizojmë qytetarët të tregojmë që shporta është për më shumë mbeturinën në të

FOLESI

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, apo UNDP, dëshiron që njerëzit të vetëdijësohen për veprimet e tyre, dhe që kjo mund të ndikojë në ambientin dhe shëndetin publik. Michele O Dea është analiste e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara

MICHELE O DEA (UNDP)

Me të vertet gjërat shumë të vogla bëjnë dallimin, dhe kjo është qeshtëja me problemet e ambientit, përshkak se kanë ndikime afatgjata dhe gjithashtu kanë ndikime të gjera, jo vetëm ndikime të menjehershme që kur shoh mbeturinat në tokë dhe nuk nuk të pelqejnë se si duken ato, por, pastaj me sa duket gjithçka e ka efektin

domino dhe kjo shpie ne probleme shendetesore

NARRATOR

Nje aksion i gjërë per pastrimin e Kosoves eshte bere me 24 Maj. Kjo ka qene nje ngjarje e rendesishme per Luan Hasanajn

LUAN HASANAJ (SHOQERIA CIVILE)

Cfare do te ndodhe sot, do te duhej te ndodh cdo dite. Ne duhet te bashkohemi te kujdesemi per ambientin duke I larguar me shume se 800 deponi mbeturinash ne te gjithë Kosoven.

FOLESI

Stafi I Kombeve te Bashkuara ka marre pjese ne aksionin e pastrimit, qe eshte mbajtur ne te gjithë Kosoven. Nora Sahatciu, kas sjellur me vete edhe familjen e saj.

NORA SAHATCIU (U.N. KOSOVO TEAM)

Ne mendojme se kjo iniciative eshte shume e rendesishme, jo vetem se ne kontribojme ne nje menyre specifike per te ndihmuar ta krijojme nje mjedis te paster, por eshte nje model the thirrje per veprim per te gjithë qytetaret, per ate se cfare mund te bejne ata si individ ne menyre qe ta ndihmojne komunitetet e tyre.

FOLESI

45 mijë qytetar kane marre pjese ne iniciativen per pastrimin e Kosoves, por , ende mbetet pune per te bere. Ne fjalet e Sekretarit te Pergjithshem te Kombeve te Bashkuara, Ban Ki-moon: Planeti toke eshte ishulli yne i perbashket. Le ti bashkojme forcat per ta mbrojtur ate.